



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 112/Prot.  
1

Tiranë, më 02.09.2022

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 4 datë 02.09.2022

Për

*Miratimin e botimit dygjuhësh në kuadër të projekt “Jam shqiptar”, lidhur me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë, në përputhje me legjislacionin në fuqi*

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, “*Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimitarëve në diasporë*”, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën:

V E N D O S I:

1. Miratimin e botimit dygjuhësh, në kuadër të projekt “Jam shqiptar”, lidhur me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-frëngjisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas projektit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA

Anëtarë:

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Enkeleda Riza

Z. Stefan Çapaliku

Znj. Brunilda Spahiu